



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Thirrje publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekt propozimeve të OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore si : **festivaleve, aktivitete rinore, ekspozita, manifestime** etj.

1. **Drejtoria për kulturë, rini dhe sport në komunën e Podujevës**, u bën thirrje të gjitha **OJQ-ve**, të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushat kulturore, rinisë të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në organizimin e **festivaleve, aktiviteteve rinore, ekspozita dhe manifestime kulturore, në komunën e Podujevës**.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt propozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe rinore.
3. OJQ- të mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në organizimin e fushave kulturore dhe rinore, përmes aktiviteteve si me poshtë:
 - **Festivalet**
 - **Aktivitete rinore**
 - **Ekspozita**
 - **Manifestime**
 - **Promovimi i vullnetarizmit**
 - **Fuqizimi i organizatave rinore** (*seminare, trajnime, kurse për aftësimin e të rinjëve etj.*).
 - **Edukimi jo-formal** (*stimulimi i të miturve për edukim dhe arsim*).
 - **Integrimi i grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara**
4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes është **35.000 €**
5. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është **200 €**, ndërsa shuma maksimale për një projekt është **3.000 €**.

Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune, nga data 30.03.2018 deri me 19.04.2018

OJQ-të mund të aplikojnë vetëm me një projekt.

Periudha e zbatimit deri në muajin dhjetor.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare, në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të deshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat si: festivalet, aktivitetet rinore, ekspozita dhe manifestime.

- Kërkesës duhet ti bashkëngjiten edhe dokumentet :
- Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së;
- Kopja e Certifikatës së Numrit Fiskal;
- Plani i punës dhe programi së paku për një vit
- Kopja e Letërnjoftimit;
- Vërtetimi Bankare.
- Të dhënat e aplikuesit: telefoni , email adresa
 - Formulari i projekt-propozimit
 - Formulari i propozim buxhetit
 - Formulari i deklaratës së partneritetit;
 - Formulari i deklaratës mbi financimin e dyfishtë

Formularët mund të merren në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport si dhe të shkarkohen online në faqen e Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujevel>

OJQ-të duhet po ashtu të kenë të kryer obligimet financiare në menyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dërgohen në zyrën nr.14 në komunën e Podujevës në zarfe të mbyllura.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit, vlerësimit dhe dhënia e fondeve të aplikuesve janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe, të cilat i permbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.



Drejtor
Donika Sfishta
Donika Sfishta